



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



Anr.679/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lista e Pavarur Bekim Jashari, me seli në Skenderaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dhe subjekti politik NISMA Socialdemokrate, me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit, në vendvotimin 2103b/01R, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura më datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht e bazuar ankesa Anr.679/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të keqpërdorimit në QV2103b/01R, ashtu që i NDALOHET Hafiz Jashari, me numër personal [REDACTED], Kryesues i Vendvotimit QV2103b/01R, në Skenderaj, pjesëmarrja në zgjedhje, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor për periudhën kohore, në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, nga dita e marrjes së vendimit.

II. REFUZHET e pabazuar, pjesa e ankesës me të cilën ka kërkuar që të përsëritet votimi, në Vendvotimin QV2103b/01R.

A r s y e t i m

Me datën 18.10.2021, PZAP-i ka pranuar një ankesë subjektit politik Lista e Pavarur Bekim Jashari, me seli në Skenderaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dhe ndaj Subjektit Politik NISMA Socialdemokrate, me të cilën pretendon se në vendvotimin numër 2103b/01R, gjatë procesit të votimit janë hasur parregullsi duke evidentuar një (1) fletëvotim të pavulosur i cili është evidentuar në librin e shënimeve dhe e njëjta është futur në votat e pavlefshme. Sipas parashtresës të ankesës shihet se ka pasur manipulim të procesit zgjedhor përmes të ashtuquajturit “treni bullgar”.

Kërkojnë që Qendra e votimit me numër 2103b/01R, të përsëritet votimi- rivotim.

PZAP, më datë 19.10.2021 i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesë për përgjigje lidhur me ankesën Anr.679/2021 me të cilën ka kërkuar që t'i ofrojë PZAP-së Librin e Vërejtjeve për vendvotimin nr.2103b/01R, në Skenderaj duke i dhënë mundësinë që të përgjigjet deri më datë 19.10.2021 në ora 15:00. Duke vepruar sipas kërkesës së PZAP-së, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 19.10.2021, ka paraqitur pranë PZAP-së Librin e Votimit për Vendvotimin nr.2103b/01R, në Skenderaj.

PZAP, më datë 19.10.2021, i ka paraqitur kërkesë për përgjigje Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), lidhur me ankesën Anr.679/2021, në të cilën pretendojnë se në qendrën e votimit të cekur në ankesë është verifikuar një fletëvotim i pa vulosur, dhe se sipas tyre është me rëndësi që të merret parasysh fakti se është e pamundur që të ndodhë “treni bullagar” për shkak të identifikimit të fletëvotimeve sepse të njëjtat kanë numër serik unik dhe numrin e vendvotimit të personalizuar. Më tej në përgjigje theksojnë se Këshilli i VV përbëhet nga pesë (5) anëtarë dhe procesi është evidentuar si i rregullt.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se: **Ankesa është pjesërisht e bazuar**

PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura, konstatoi se ankesa është pjesërisht e bazuar në pjesën që ka të bëjë se në vendvotimin lëndor është një fletëvotim i pa vulosur në kutin e votimit, kjo është konstatuar nga shkresat e ofruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, andaj në raport me këto parregullsi paneli vendosi si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, në të cilin parashihet se: *“Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve PZAP-i mundet d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite”*. Lëshimet e pretenduara dhe të konstatuara nga paneli i atribuohen përgjegjësisë së kryesuesit të vendvotimit sipas nenit 74.10, pasi integritetit i procesit mbetet përgjegjësi e kryesuesit. *Me nenin 74.10 të LZP-së përcaktohet “ KVV-ja është përgjegjëse për sigurimin e integritetit, sigurisë dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në Vendvotim nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë nga KKZ-ja”*.

Në raport me pjesën refuzuese për urdhërimin e përsëritjes së votimit Paneli i vlerëson se mospërputhja e rezultatit konstatuar si më lart nuk është bazë e mjaftueshme dhe me peshë në rezultat për të urdhëruar përsëritjen e votimit në vendvotimin e pretenduar, bazuar në nenin 117 paragrafi 3 dhe nenin 118, të LZP-së, ngase nuk janë ofruar dëshmi të qarta dhe bindës se ka pas parregullsi të asaj natyre për te ndikuar në vendimmarrje ndryshe në këtë rast, siç është vendosur në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi.

Nga arsyet e lartcekura paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.679/2017 më datën 20.10.2021.



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*